

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 44/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të Komisionit Disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. _____, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në _____, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, dhe përmbaruesit privat z. _____, dhe pas seancës këshillimore, me datën 19.11.2021, mori si në vijim:

V E N D I M

REFUZOHEN raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-44/2021, datë 11.10.2021, si dhe ankesa pala ankuese znj. _____, dt 08.10.2021, si të pasafatshme.

A R S Y E T I M

Me datën 28.09.2021, përkatësisht me dt 08.10.2021, pala ankuese znj. _____ ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat z. _____, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në _____. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat ka kryer shkelje të dispozitës së nenit 9 dhe nenit 367 par 1.2 të LLP-së, ashtu që me ndërmarrjen e veprimeve përmbarimore nuk ka respektuar dinjitetin e palës duke imponuar marrëveshjen me debitorin. Pala ankuese thekson se në urdhrin përmbarimor është përmendur marrëveshja e pengut, ku pala ankuese pretendon se kjo marrëveshje është rikrijuar vetvetiu me dt 26.05.2015, sepse sipas palës ankuese znj. _____, ajo ka nënshkruar vetëm njëherë dhe atë kur kishte marr kredinë me dt 12.04.2012. Po ashtu, pala ankuese znj. _____ thekson se ka ushtruar në Gjykatën

kompetente kërkesën për eliminimin e parregullsive për të cilën kërkesë pala edhe pas një viti deklaroi se nuk ka pranuar asnjë përgjigje.

Me datën 11.10.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarruesit private z. _____, si organ përmbarrues, i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në _____, lidhur me veprimet përmbarrimore në lëndën përmbarrimore P. nr 221/2019.

Përmbarruesi privat z. Jeton Krasniqi në përgjigjen e tij me shkrim me 12.10.2021, ka bashkangjitur dy (2) vendime, njëra e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë PPP. Nr 195/19 dt 31.01.2020 dhe tjetra nga Gjykata e Apelit e Kosovës Ac. Nr 1522/2020, dt 25.09.2020, dhe ka kërkuar refuzimin e ankesës.

Me datën 19.11.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, dhe përmbarruesit privat, z. _____. Pala ankuese znj. _____ nuk ka prezantuar, megjithatë, ajo ka dërguar një deklaratë në formë të shkruar, me anë të cilës ka theksuar se qëndron pranë ankesës së saj të paraqitur.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, ka bërë shtjellimin e Raportit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarruesit privat duke theksuar se mbetet pranë tij. Përmbarruesi privat z. _____ po ashtu kanë paraqitur qëndrimin e tij dhe ka kërkuar refuzimin e raportit.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se ankesa ndaj përmbarruesit privat është e pasafatshme.

Komisioni gjen me rëndësi të thekson që neni 375 i LPP-së, shprehimisht përcakton që *“procedura disiplinore (ndaj përmbarruesit privat theksimi i shtuar) mund të fillohet brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga dita e shkeljes së bërë, por jo më vonë se një (1) vit nga dita e shkeljes.”* Kjo do të thotë se procedura disiplinore ndaj përmbarruesve privat më së voni mund të fillohet brenda një (1) viti nga dita e shkeljes së pretenduar disiplinore. Nëse ndonjë pasojë që përbën element të veprës disiplinore shfaqet më vonë, afati fillon të rrjedh nga ajo kohë. Në rastin në fjalë, pala ankuese, së pari, pretendon që përmbarruesi privat ka kryer shkelje të dispozitës së nenit 9 dhe nenit 367 par 1.2 të LLP-së, ashtu që me ndërmarrjen e veprimeve përmbarrimore nuk e ka respektuar dinjitetin e palës debitorë, këtu palës ankuese, duke imponuar marrëveshjen me debitorin, dhe së dyti, pala ankuese pretendon që në urdhrin përmbarrimor është përmendur marrëveshja e pengut, ku pala ankuese pretendon se kjo marrëveshje është rikrijuar vetvetiu me dt 26.05.2015, sepse sipas palës ankuese znj. _____ ajo ka nënshkruar vetëm njëherë dhe atë kur kishte marr kredinë me dt 12.04.2012.

Meqenëse pretendimet për shkelje disiplinore i referohen urdhrin përmbartimor dhe marrëveshjes mbi kredinë të cilat datojnë 17.06.2019 përkatësisht 12.04.2012, atëherë si të tilla, për këto pretendime për shkelje disiplinore nga ana e përmbartuesit privat z. [i] ka kaluar afati prej një (1) viti brenda të cilit mund të fillohej procedura disiplinore ndaj tij pranë Komisionit Disiplinor. Rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor është i kufizuar të jap vlerësimin e tij lidhur me meritat e ankesës.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 44/2021, datë 19.11.2021

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.



THE UNIVERSITY OF CHICAGO PRESS

CHICAGO, ILL.

1900